

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.911/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit A.K. nga ..., për shkak të veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 2 në lidhje me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2500/2018 të datës 29.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 25.01.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Danijela Batkovic dhe të pandehurit, me datë 28.01.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.01.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. K., nga i ati H. dhe e ëma G., e vajzërisë T., i lindur me datë ... në ..., ku edhe jeton, ... , i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. Personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

Me datë 21.04.2018, rreth orës 22:45, në ..., në Rr. ..., njësia patrulluese e trafikut të Stacionit Policor Jugor të Mitrovicës, pas një kontrolli të rregullt dhe bastisjes së automjetit Golf IV, ngjyrë e bardhë, me targa ..., të cilin e drejtonte A.K. me bashkëudhëtarë J.Z. dhe B.S., e kontrollimin në xhepin e djathtë të pantollonave të A.K. kanë gjetur dy kесе të palstikës në të cilat ka pasur substancë narkotike - marihuanë (kanabis), e cila përmban substancën tetrahidrokanabinol (THC), në peshë prej 2.40 gram, të cilën substancë psikotrope e ka poseduar pa autorizim dhe për përdorim personal të cilën e ka siguruar nga NN personi në afërsi të Ibrit.

Me këtë ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 2 në lidhje me par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, të KPRK-se, dhe nenit 450, 460 të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 350 € (treqindë e pesëdhjetë euro) të cilën shumë bligohet ta paguaj brenda afatit prej tre (3) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, atëherë kjo shumë e dënimit me gjobë i shndërrohet menjëherë në dënim me burgim sipas ligjit.

II. OBLIGOHET i pandehuri A. K., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.2500/2018 të datës 29.10.2018, kundër të pandehurit A. K. nga ..., për shkak te veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 2 në lidhje me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri: e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë si dhe ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur dhe ka premtuar se nuk do të kryej sjellje të tilla në të ardhmen.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri A. K., e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Deklarata e të pandehurit dhënë në polici e datës 23.04.2018; Vërtetimi mbi mjetet e konfiskuara të datës 24.07.2018; Konstatimin e ekspertit të forenzikës të datës 05.07.2018; Deklarata e dëshmitarit B. S, dhënë në polici e datës 23.04.2018; Deklarata e dëshmitarit J. Z. dhënë në polici e datës 23.04.2018; Evidenca penale në emër të pandehurit; Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri A. K.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 2 në lidhje me par. 1 të KPRK, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje, faktin se këto vepra penale janë rritje e sipër. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehe keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, ne raport me gjykatë dhe palët, faktin se është i moshës së re.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimn viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.911/2018, dt.29.01.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.